



## TË DHËNAT PËR ASETIN

Shitja e Aseteve me Likuidim nr. 49

Njësia nr. 52

NT Ereniku Tregtia Shitorja në Brekoc

<b>Emri i NSH.-së</b>	NT "Ereniku Tregtia", Gjakovë (" <b>Ndërmarrja</b> ")
<b>Lloji i shitjes</b>	Shitja me Likuidim me ofertë të mbyllur
<b>Dita e Ofertimit</b>	21.08.2019 në sallën e konferencave në "Hotel Grand" - Prishtinë
<b>Depozita e Ofertës</b>	Euro 8,000
<b>Vendndodhja e Asetit</b>	Brekoc, Komuna Gjakovë
<b><u>Përshkrimi i Asetit</u></b>	<p>Kjo shitje ofron lokalin afarist si dhe parcelën nr. 380-2 ku shtrihet lokali, me sipërfaqe 57m<sup>2</sup> sipas certifikatës së pronës, sipas matjeve objekti ka 93.4m<sup>2</sup> bruto dhe ndodhet në ZK Brekoc, Komuna Gjakovë. Sipërfaqja subjekt i shitjes është 93.4 m<sup>2</sup>, dhe do të jetë përgjegjësi e blerësit të bëjë regjistrimin e objektit në libra kadastral për pjesën e objektit të ndërtuar në pronën komunale.</p> <p>Sipërfaqja e dyqanit që shtrihet në parcelën nr. 380-2 në pronësi të NT Tregtia, Gjakovë sipas certifikatës së pronësisë është 57m<sup>2</sup> ndërsa sipas matjeve është 54.15 m<sup>2</sup>.</p> <p>Pjesa e pasme e dyqanit në sipërfaqe 39.27m<sup>2</sup> shtrihet në parcelën nr. 381-2 e cila evidentohet në pronësi të Kuvendit Komunal Gjakovë, andaj toka ku ndodhet kjo pjesë e dyqanit NUK është përfshirë në shitje. Prona ka qasje në rrugë publike përmes parcelës 381-2.</p> <p>Me datë 09.08.2018 i jemi drejtuar Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis të Komunës së Gjakovës për sigurim të lejes së ndërtimit apo ndonjë dokumenti tjetër relevant lidhur me ndërtimin e aneksit të objektit në parcelën nr. 381-2, ku nga kjo Drejtori kemi pranuar përgjigje me datë 24.08.2018 përmes së cilës jemi informuar që kjo Drejtori ka kërkuar dokumente edhe në arkivin regjional të Gjakovës lidhur me kërkesën për sigurim të dokumenteve të lartcekura mirëpo nuk kanë arritur të gjejnë ndonjë dëshmi lidhur me lejen e ndërtimit për aneksin e ndërtuar në parcelën nr. 381-2.</p> <p>Shënim: Pas publikimit të SHAL38, janë pranuar 3 kërkesa për ndalimin e shitjes dhe blerje me negociim direkt dhe janë dërguar përgjigje:</p>



### Shfrytëzuesit

- kërkesë nga qiraxhiu i lokalit për ndalimin e shitje (pranuar me dt. 16.11.2017) e refuzuar (dt. 29.11.2017);
- kërkesë nga Avokati Publik i Komunës Gjakovë (pranuar me dt. 20.11.2017) me arsyetimin se shitja e objektit e qet jashtë funksioni dhe len pa qasje tokën komunale mbi të cilën shtrihet pjesa e objektit në shitje, duke përmendur edhe kërkesën e palës (qiraxhiut) dërguar Komunës për anulim shitje. Kërkesa refuzuar e pa bazë (24.11.2017);
- kërkesë nga një palë e tretë për ndalim shitje dhe negociim direkt, pala është njoftuar se është bërë publikimi i shitjes që ofron mundësi të barabarta dhe se nuk ka karakteristika të asetit specifik (neni 4 i Rregullores), andaj refuzuar (dt. 30.11.2017).

Ekziston një kërkesë për lëshimin e urdhrin paraprak lidhur me tenderimin e asetit e cila është refuzuar nga DHPGJS si e pa bazuar me aktvendimin C-III-18-0026 dt. 19.12.2018.

Lokali shfrytëzohet nga qiramarrësi me kontratë qiraje deri me 25.11.2019.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

## Ortofoto për asetin në shitje



## Informatat

Departamenti i Marketingut, Marrëdhënie me Publikun dhe Investitorë

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +381 (0) 38 500 400 ext. 1105, 2055

Fax: +381 (0) 38 248 076

[www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

## Dokumentet e Ofertimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga: Agim Ramadani Nr. 23

10000 Prishtinë/ Pristina, Kosova

Informatat që janë dhënë në këtë publikim mund të kenë pasaktësi, lëshime, ose gabime tipografike për të cilat Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk do të jetë në asnjë mënyrë përgjegjëse e as nuk do të pranojë përgjegjësi lidhur me përdorimin, vlefshmërinë, saktësinë, plotësinë ose besueshmërinë, pa marr parasysh natyrën e tyre. Investitorët e mundshëm inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) të kërkojnë dosjen elektronike dhe dokumentet për ofertim. Është në përgjegjësinë e secilit ofertues të mundshëm, që të bëjë hulumtimin paraprak në lidhje me NSH-në apo artikujt e tenderuar, me qëllim të mbledhjes së informatave të nevojshme. Këto të dhëna janë në dispozicion sipas kushteve të përgjithshme të cekura në Rregullat e Tenderit të cilat mund të merren nga faqja e AKP-së në internet: [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)